



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
Nr. 1023 Prot
Tiranë, mi 18.01.2024



SHËRBIMI GJEOLLOGJIK SHQIPTAR
Nr. 812 Prot
Tiranë, më 18.01.2024

Marrëveshje bashkëpunimi

ndërmjet

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

dhe

Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

Për zhvillimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta në fushën e gjeoshkencave

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), me qendër në Tiranë, shetitorja Murat Toptani, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar; dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (më tej: SHGJSH), me adresë: rruga "Zef Serembe", Tiranë, përfaqësuar nga dr. Adrian Bylyku, Drejtor i Përgjithshëm; të quajtura në vijim Palë, bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje, duke konsideruar si objektiv kryesor të saj rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellët ndërmjet dy institucioneve në fusha me interesa të përbashkët shkencorë.

Neni 1
Qëllimi

Palët zotohen të ndërmarrim projekte dhe studime të përbashkëta në fushën e gjeoshkencave, brenda kuadrit të përgjegjësisë së tyre, duke krijuar përmes kësaj marrëveshjeje kornizën juridike që lehtëson procedurat dhe nxit rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellët ndërmjet tyre, në përputhje me interesat e përbashkëta.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 53/2029 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (i ndryshuar) dhe në Ligjin nr. 111/2015 *Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar*. Aktet nënligjore dhe ato të brendshme të dy institucioneve dalë në zbatim të këtyre ligjeve respektohen nga Palët.

Neni 3
Parime bazë

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin është *liria akademike dhe autonomia institucionale*. Palët bashkëpunojnë duke respektuar njëratjetrën në *vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore*, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektesh e veprimitarish të përbashkëta kërkimore-shkencore.

Në veprimitaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë dhe respektojnë *Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 4
Informimi reciprok

Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbim të ndërsjellë të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive.

Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimitarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.

Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshjeje realizohet edhe nëpërmjet:

- a). Shkëmbimit të ndërsjelltë të informacionit dhe publikimeve;
- b). Projekteve kombëtare dhe ndërkontinentale me interes të dyanshëm;
- c). Pjesëmarrjes së përbashkët në konferenca, simpoziume dhe tryezat shkencore me interes të përbashkët;
- ç). Informimit reciprok për aplikime me interes, të përbashkët ose jo.

Neni 5

Drejtimet kryesore të bashkëpunimit

Palët bëjnë kërkime të përbashkëta në fushën e gjeoshkencave.

Secila nga *Palët* cakton një koordinator për ndjekjen e projekteve konkrete të përbashkëta. *Palët* këmbejnë listat e bashkëpunëtorëve kryesorë që mund të përfshihen në nismat e përbashkëta shkencore.

Për çdo projekt *Palët* bien dakord për përbërjen e grupit të kërkuesve.

Rezultatet e veprimtarive të përbashkëta shkencore *Palët* ofrojnë mundësi për publikimin e tyre me përparësi në periodikët shkencorë A-JNTS dhe *Buletini i shkencave gjeologjike*.

Palët vendosin bashkërisht, rast pas rasti, për mënyrën e qarkullimit të informacionit shkencor, duke e publikuar apo në mënyrë konfidenciale, duke garantuar mbrojtjen e pronësisë intelektuale sipas legjispcionit.

Neni 6

Komunikimi

Palët mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe shkëmbujnë vlerësimë e relacione periodike për nismat e përbashkëta shkencore.

Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjellë.

Komunikimi mes tyre realizohet në gjuhën shqipe, në formë shkresore ose në rrugë elektronike.

Neni 7

Financimi

Për ndarjen e përgjegjësive për financimin e nismave shkencore (projekte, kërkime, studime, konferanca) *Palët* merren vesh rast pas rasti, mbi bazën e preventivave që paraqiten.

Për rastet e projekteve të fituara me konkurrim prej palësh të treta, vendëse dhe të huaja (AKKSHI, agjenci dhe programe ndërkombëtare të mbështetjes së kërkimit shkencor) *Palët* bien dakord paraprakisht për masën e kontributit që mund të ofrojnë.

Palët mund të aplikojnë së bashku edhe në rastet kur vetëm njëra prej tyre ka mundësi pjesëmarrjeje në financim.

Neni 8
Zbatimi dhe kohëzgjatja

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat trevjeçar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët.

Çdo ndryshim i mundshëm i kërkuar nga Palët në tekstin e marrëveshjes ekzistuese bëhet nëpërmjet komunikimit me shkrim.

Palët u përbahen kushteve që rrjedhin nga kjo marrëveshje deri në përfundim të saj për sa u përket informacionit, shërbimeve të ofruara dhe dokumentacionit të shkëmbyer gjatë periudhën së vlefshmërisë.

Në rast të shuarjes së interesit a të mospajtimit, kjo marrëveshje mund ta humbasë fuqinë e veprimit, me kërkesën e arsyetuar me shkrim të secilës nga Palët, të paraqitur së paku 30 ditë përpara.

Ndërprerja e saj pranohet prej Palëve në rastet kur:

- a). Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;
- b). Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e realizimit. Kontratat e nënshkruara për aq kohë sa marrëveshja është në fuqi kanë vlerë zbatuese deri ne përfundimin e tyre.

Neni 9
Mospajtimet

Mospajtimet lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhen me mirëkuptim.


Neni 10
Të fundme

Marrëveshja nënshkruhet në 4 (katër) kopje, nga dy për secilën Palë, me vlerë të barabartë.

Për Akademinë e Shkencave të

Shqipërisë

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar



Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar

Dr. Adrian Bylyku

Drejtor i Përgjithshëm

